



# THE VENUS PROJECT

përtej politikës, varfërisë dhe luftës



Projekti Venus është një organizatë që ofron plane të zbatueshme për ndryshim social, plane që mund të arrijnë një qytetërim paqësor dhe të qëndrueshëm global.



NJOFTIM PËR SHTYP 2012

[WWW.THEVENUSPROJECT.COM](http://WWW.THEVENUSPROJECT.COM)





# Çfarë është Projekti Venus?

Projekti Venus është një organizatë që ofron një plan të realizueshëm veprimi për ndryshim shoqëror që punon për një qytetërim paqësor dhe të qëndrueshëm global. Ajo përshkruan një alternativë ku të drejtat e njeriut nuk ekzistojnë vetëm në deklaratata, por janë një mënyrë e vërtetë jetese.

Projekti Venus bën thirrje për një ripërcaktim të kulturës sonë, në të cilën problemet e vjetra të luftës, varfërisë, urisë, borxhit, dhe vuajtjeve të panevojshme të njeriut shihen jo vetëm si të shmangshme, por si krejtësisht të papranueshme. Ai paraqet një vizion alternativ ndryshe nga çdo sistem politik, ekonomik dhe social që është provuar më parë. Parashikon një kohë në të ardhmen e afërt, ku paraja, politika, interesat private dhe kombëtare do të zhduken. Ndonëse ky vizion mund të duket idealist, ai bazohet në më shumë se 75 vite studime dhe kërkime eksperimentale nga Jacques Fresco.

Ndërkohë që sfidat globale dhe informacionet shkencore shumëfishohen, njerëzit dhe kombet përballen me kërcënime të përbashkëta që i kalojnë kufijtë kombëtar. Mbiipopullimi, mungesa e energjisë, ndotja e mjedisit, mungesa e ujit, katastrofat ekonomike, përhapja e pakontrolluar e sëmundjeve dhe zëvendësimi i njerëzve në punë nga makineritë, është kërcënim për të gjithë ne. Megjithatë shumë njerëz përpiqen t'i lehtësojnë këto kushte, problemet tona sociale dhe mjedisore do të mbeten të pakapërcyeshme për aq kohë sa disa kombe të fuqishme dhe interesa financiare ruajnë kontrollin dhe konsumojnë shumicën e burimeve të botës

Sot ne kemi akses në teknologji që janë në gjendje të llogarisin dhe menaxhojnë burimet tona në nivel global, për të siguruar lehtësisht një standart të lartë jetese për të gjithë. Teknologjia jonë ecën me hapa gjigand përpara, por ne nuk



po bëjmë të njëjtën gjë në lidhje me proceset e risive për analizimin e sistemeve tona sociale dhe metodave të menaxhimit dhe shpërndarjes së burimeve tona globale. Me aplikimin inteligjent dhe human të shkencës dhe teknologjisë, njerëzit e Tokës mund ta drejtojnë të ardhmen së bashku, duke mbrojtur mjedisin në të njëjtën kohë. Praktika aktuale e racionimit të burimeve nëpërmjet metodës monetare është e pavend, kundër produktive dhe shumë larg nga përmbushja e nevojave të njerëzimit.

*"Të gjitha arritjet e shkencës dhe të teknologjisë, të gjitha mrekullitë elektronike dhe mekanike, janë thjesht miliona ton mbeturina veç në mos përmirësojnë jetët e njerëzve." - Jacques Fresco*

Nuk është më e nevojshme të përjetësojmë tërheqjen e ndërgjegjshme të efektshmërisë nga vjetrimi i planifikuar i tij dhe të mbajmë një sistem ekonomik të bazuar mbi borxhin që gjeneron mungesën artificiale. Nëse jemi vërtetë të

shqetësuar për mjedisin dhe njerëzit, nëse duam të eliminojmë mosmarrëveshjet territoriale, luftën, krimin, varfërinë dhe urinë, duhet të shqyrtojmë proceset shoqërore që janë përgjegjëse për shumicën e problemeve tona. Të ndërgjegjshëm apo jo, është ekonomia me bazë fitimin dhe vlerat materiale ajo që i shkakton këto probleme. Kemi arritur në një kohë ku rrisitë e fundit në shkencë dhe teknologji mund të ofrojnë shumë lehtë bollëk për të gjithë njerëzit e botës nëse i drejtojmë në mbrojtjen e mjedisit dhe në mirëqënien e të gjithëve. Projekti Venus propozon një plan për ta arritur këtë.





# Çfarë është një Ekonomi e Bazuar në Burime?

Jacque Fresco shpiku termin "Ekonomi e Bazuar në Burime". Bëhet fjalë për një sistem në të cilin të gjitha të mirat dhe shërbimet janë të disponueshme pa përdorimin e parasë, kredisë, borxhit apo të çdo lloj nënshtrimi.

Nuk ekzistojnë mjaftueshëm para' për të arritur bollëkun universal por ne kemi burime mëse të mjaftueshme. Kjo është arsyeja pse Projekti Venus propozon të punojmë drejt një Ekonomie Globale të Bazuar në Burime, në të cilën burimet planetare do ekzistojnë si trashëgimi e përbashkët e të gjithë banorëve të Tokës. Me pak fjalë, një ekonomi e bazuar në burime përdor burimet ekzistuese, jo paratë, për të siguruar një metodë të barabartë të shpërndarjes në mënyrë sa më humane dhe efektive.

Për ta kuptuar më mirë një ekonomi të bazuar në burime, mendoni këtë: nëse të gjitha paratë e botës do të zhdukeshin gjatë një nate, për sa kohë toka, fabrikat, personeli dhe burimet e tjera mbeten të paprekura, ne mund të ndërtojmë çdo gjë që na nevojitet për plotësimin e nevojave njerëzore. Nuk janë paratë për të cilat njerëzit kanë nevojë, por më saktë akses të lirë tek domosdoshmëritë e tyre, pa u shqetësuar për sigurinë financiare apo t'i drejtohen burokracive administrative. Në një ekonomi bollëku të bazuar në burime, paratë do të bëhen të parëndësishme.

Një ekonomi e bazuar në burime përdor teknologjinë për të kapërcyer mungesën e burimeve me aplikimin e energjisë së ripërtëritshme, automatizimin e prodhimit dhe të inventarit, projektimin e qyteteve energjikisht efikas; , sigurimin e kujdesit shëndetësor universal, duke ofruar edukim domethënës dhe duke gjeneruar një sistem të ri stimulues që bazohet në të mirën e njeriut dhe të mjedisit. Ne nuk jemi të ndarë nga natyra. Duhet të mësojmë të jetojmë në përputhje me kapacitetin bartës të burimeve të Tokës.

Disa pyesin se çfarë do të ndodhë me motivin nëse nevojat tona do të plotësoheshin pa pasur nevojën e punës për t'i përmbushur ato. Pyetja supozon se njerëzit nuk kanë dëshirë përtej nevojave themelore.

Nëse kjo do ishte e vërtetë, nuk do të ekzistonin shpikësit, shkrimtarët dhe as mësuesit. Njerëzit punojnë me pasion për gjëra që u interesojnë dhe që i shtyn ata të sfidojnë vetveten. Motivimi dhe stimujt ekzistojnë kur njerëzit bëjnë detyra që kanë kuptim. Motivimi dhe stimujt vdesin në punët monotone të përsëritura dhe të mërzitshme që bëhen vetëm për të marrë një pagesë. Rritja e vërtetë dhe zhvillimi ndodhin kur njerëzit janë të përfshirë në aktivitete krijuese, sfiduese dhe konstruktive.

Kombet janë të varur nga njëri-tjetri. Historia që i tregojmë vetes është se kombet mundën ende të vazhdojnë të jenë të pavarur nga të tjerët dhe nga impakti i ndryshimeve teknologjike që shtohen rreth nesh. Projektet tona për qytetin, kanalet e lundrueshme, sistemet e energjisë, qendrat e prodhimit dhe të shpërndarjes, si dhe sistemet e transportit duhet të riprojektohen që të funksionojnë si një sistem i bashkuar, i integruar dhe global. Në këtë mënyrë, ne mund të përdorim teknologjinë tonë për të kapërcyer mungesën e burimeve, për të siguruar bollëk të përgjithshëm dhe mbrojtjen e mjedisit. Projekti Venus punon me plane, metodologji dhe sisteme procedurale për ta arritur këtë qëllim.

Vizioni i Projektit Venus për aplikimin e shkencës dhe teknologjisë së pastër në sistemin social do të shërbejë për mirëqenien e të gjithë njerëzve, një objektiv ky që i ka shpëtuar vëmendjes së qytetërimit njerëzor ditët e sotme. Mundësitë tona për një jetë më të mirë për të gjithë, përfundimisht, varen nga vendimet që ne do të marrim sot. Nuk mjafton thjesht të ankohe mi për padrejtësitë dhe mizoritë e pandreqshme të botës sonë. Po bëhet gjithnjë dhe më urgjente të zhvillojmë qasje të reja për zgjidhjen e problemeve tona. Projekti Venus ofron një koncept global dhe një ftesë për të eksploruar, diskutuar dhe zhvilluar të ardhmen së bashku.



# Jacque Fresco

Eksperiencia e Jacque Fresco përfshin projekte industriale dhe inxhinieri sociale. Është një lajmëtar në fushën e inxhinierisë së faktorëve njerëzorë. Fresco ka punuar dhe si projektues dhe shpikës në një gamë të gjerë sektorësh nga risitë biomjekësore deri tek sistemet sociale tërësisht të integruara.

Projekti Venus reflekton kulmin e punës së jetës së Jacque Fresco-s: integrimin e më të mirës së shkencës dhe të teknologjisë në një plan gjithëpërfshirës për një shoqëri të re të bazuar në përkujdesjen e njeriut dhe mjedisit. Është një vizion global shprese për të ardhmen e njerëzimit në epokën tonë të teknologjisë.


Një dokumentar i rëndësishëm me titull "Future by Design" paraqet jetën, projektet dhe filozofinë e Jacque Fresco-s. Është prodhuar nga regjizori kandidat për çmimin Oskar dhe fituesi i Emmy, William Gazecki.

Jacque Fresco dhe Projekti Venus paraqiten gjithashtu në filmat Zeitgeist Addendum dhe Zeitgeist Moving Forward të prodhuar nga Peter Joseph.

## Disa nga Shpikjet dhe Projektet e Jacque Fresco:

- *Sisteme për avion jo ndotës dhe pa zhurmë*
- *Një sistem i ri strukturor krahësh aeroplani, i patentuar nga US Air Force*
- *Një sistem elektrostatik për eliminimin e shpërthimit zanor për Raymond Delcer*
- *"The Aluminum Trend House", një shtëpi e parafabrikuar projektuar dhe zhvilluar për Mike Shore dhe Earl Muntz, 1945*
- *Zhvilloi pajisje të ndryshme, nga njësi 3 dimensionale rrezesh X deri në instrumente elektronike kirurgjike për sektorin e mjekësisë*

Shumë nga projektet dhe shpikjet e Fresco janë patentuar, ndërkohë që janë pranuar gjerësisht në treg.



## Libra që ka shkruar

- *Looking Forward co-authored with Kenneth Keyes, 1969, A.S. Barnes & Company*
- *The Venus Project: The Redesign of a Culture, 1995*
- *World Future Society best seller*
- *The Best That Money Can't Buy: Beyond Politics, Poverty & War, 2002*
- *Designing the Future, 2007*

## Video që ka prodhuar dhe xhiruar

- *The Venus Project: The Redesign of a Culture, 1994*
- *Welcome To The Future, 2001*
- *Cities In The Sea, 2002*
- *Self-erecting Structures, 2002*
- *Designing the Future, 2006*



Z. Fresco ka qenë i ftuar në shumë institucione të arsimit të lartë. Ishte një pjesëmarrës aktiv në diskutime në Qendrën për Studimin e Institucioneve Demokratike në Santa Barbara, në Kaliforni. Ai dhe Ralph Nader ishin të ftuar si lektorë në Universitetin e Florida-s Jugore. Në Universitetin Princeton, z. Fresco iu drejtua Departamentit të Sociologjisë. Subjekti i tij ishte Sociologjia për të Ardhmen. Bashkë me shkencëtaren e njohur Margaret Mead, z. Fresco u ftua që të merrte pjesë në Konferencën Ekologjike në Washington D.C. Ishte i ftuar si lektor tek Tenth Symposium për Departamentin e Inxhinierisë Civile të Universitetit TEC de Monterrey në Monterrey të Meksikës, universiteti më i shquar i Amerikës Latine. Z. Fresco ishte ftuar si lektor tek The Utopian Studies Conference në Orlando në Florida dhe dha leksione në disa World Future Society Conferences. Ishte i ftuar si lektor për projektimin e ardhshëm në Dubai në Emiratet e Bashkuara Arabe. Z. Fresco ishte folës në Universitetin Teknik në Vjenë. Ishte lektor i ftuar në konferencën në Dalian në Kinë për Zhvillimin e N.E China. Ishte gjithashtu lektor i ftuar në një konferencë në Islandë dhe i ftuari special tek The Futurist Summit më 2008-ën në Stamboll në Turqi. Më 2010-ën Jacques Fresco dhe Roxanne Meadows përfunduan World Lecture Tour, duke folur në mbi 18 shtete.

Prezantimet e z. Fresco reflektojnë një përpjekje serioze për të vënë në dukje shkaqet e problemeve aktuale dhe përvijimin e një gamë të gjerë alternativash konstruktive. Ai e bën këtë duke prezantuar një ripërcaktim të kulturës sonë, gjë që do të theksonte përdorimin inteligjent të shkencës dhe teknologjisë për të përmirësuar jetët e të gjithë njerëzve ndërkohë që mbron mjedisin tonë. Teknika e tij e veçantë e leksionit u mundëson pjesëtarëve të publikut pa njohuri teknike të kuptojnë rëndësinë e risive komplekse teknike dhe sociale. Ai flet në mënyrë dramatike dhe të shkëlqyer për problemet urgjente kalimtare me të cilat përballet shoqëria jonë bashkëkohore. Publiku përfundon me vëmendjen e tij plotësisht të përqendruar dhe ndjekin me kujdes prezantimin e tij nga fillimi gjer në fund. Leksionet e z. Fresco vlerësohen vazhdimisht dhe kuptohen me entuziazëm. Jacques Fresco është themeluesi i Sociocyberneering, Inc. , i njohur sot si Projekti Venus. Me bashkëpunëtoreshen e tij Roxanne Meadows, ka projektuar dhe ndërtuar të gjithë njësinë e hulumtimeve prej 40,4 hektarësh. Funkzioni i këtij projekti është të përgatisë qasje dhe zgjidhje për problemet kryesore me të cilat bota përballet sot. Mbështetja e projektit nga televizionet dhe revistat është globale.



# Roxanne Meadows

Roxanne Meadows studioi në Moore College of Art dhe u diplomua në Artet të Bukura nga Maryland Institute of Art. Studioi për shumë vite nën drejtimin e Jacque Fresco, modele tre dimensionale teknike dhe arkitektonike.

Sot, ajo është një ilustratore teknike dhe arkitektonike e suksesshme dhe krijuese modelesh e njohur. Meadows është një ilustratore e aftë e shkencës dhe mjekësisë.

Që nga viti 1985, Meadows furnizoi me interpretime arkitektonike, modele dhe projekte të zhvilluar me arkitektë dhe programues të specializuar nga i gjithë vendi. Ishte presidente dhe themeluese e Architectural Arts Inc. , dhe mbeti në këtë post nga viti 1997 deri në vitin 2008.

Ka dhënë mësim për art teknik dhe figurativ në Qendrat e Arteve Sebring dhe Lake Placid dhe ka punuar si animatore kompjuterike për Ken Sneed and Associates.

Nga viti 1975 deri më sot, ka punuar për futuristin e njohur Jacque Fresco për zhvillimin dhe promovimin e Projektit Venus. Ka marrë pjesë në projektimin e jashtëm dhe të brendshëm të ndërtesave të Projektit Venus, një qendër kërkimore dhe planifikuese prej 85 hektarësh.

Roxanne Meadows ka përgatitur projekte, modele dhe ka përfaqësuar plane tredimensionale për qytete të ndryshme dhe propozimet e tjera të prezantuar nga Projekti Venus gjatë 35 viteve të fundit. Shumë nga ato janë shfaqur në gazeta të ndryshme dhe revista, si dhe në televizion, në dokumentarë, nëpër filma, në faqe interneti dhe blogje.

Ajo, së bashku me z. Fresco, ka folur dhe ka drejtuar konferenca të ndryshme në të gjithë botën si një futuriste që prezantonte qëllimet dhe propozimet e Projektit Venus.



Znj. Meadows, së bashku me z. Fresco, kanë xhiruar, kuruar dhe drejtuar videot edukative:

- *Welcome to the Future*
- *A Conversation with Social Innovator & Futurist Jacque Fresco*
- *Self-Erecting Structures*
- *Cities in the Sea*
- *Designing the Future*
- *The Venus Project Tour*

Roxanne Meadows ka punuar në shumicën e shkrimeve, veç kësaj dhe në cilësinë e konsulentës për projektet, për versionet e shumta të projektit.

- Organizoi shkrimin e Jacque Fresco-s për librin *The Best That Money Can't Buy: Beyond Politics, Poverty & War* dhe projektoi paraqitjen e librit
- Organizoi shkrimin e Jacque Fresco-s për librin *Designing The Future*.
- Bashkë-autore e artikullit "Reinventing Iraq" për librin *In The Shadow of War*, një seri e redaktuar nga Arthur B. Shoshtak, Ph.D.
- Bashkë-autore e artikullit "Beyond Utopia" për librin *Utopian Thinking in Sociology: Creating the Good Society*, redaktuar dhe përmbledhur nga Arthur B. Shoshtak, Ph.D.







## Turne Botëror

Në vitin 2010 Jacque Fresco dhe Roxanne Meadows udhëtuan në mbi 18 Shtete dhe bënë më shumë se 26 prezantime të suksesshme për Projektin Venus.

## Qendra Kërkimore

Shumë nga këto ide po bëhen realitet TANI. Faza e parë e Projektit Venus është qendra kërkimore 85 hektarëshe në Florida-n e pacënuar Jug-Qëndrore, ku e ardhmja aktualisht po merr formë.

Brenda ndërtesave ekzistuese dhe qendrës së konferencave mund të shihen modele, vizatime, projekte, manifeste, libra dhe prezantime në video. Këto janë hapat e para që janë realizuar në mënyrë që të ndihmojnë dikë të shikojë, të ndjejë dhe të prek të ardhmen.

Ndërtesat e treguara janë forma e gjerave që do të vijnë, jo vetëm forma e arkitekturës, por një mënyrë jetese që është e arritshme tani. Mund të jetë e pastër, e sigurt, e teknologjisë të lartë, estetishtë e kënaqshme dhe në harmoni me natyrën. Projektin Venus tregon më të mirat e shkencës dhe teknologjisë duke ruajtur ekuilibrin e natyrës.

Për më shumë informacione rreth projektit, ju lutem vizitoni [www.thevenusproject.com](http://www.thevenusproject.com)

# Fushatë Reklamuese e Projektit Venus


## Revista

- |   |   |
|---|---|
| 1944 - <i>Great Lakes Technocrat</i>                          | 2002 - <i>The Venus Project Mare Germany</i>                                  |
| 1948 - <i>The Technocrat</i>                                  | 2002 - <i>Thinking Big About the Future - The Futurist</i>                    |
| 1948 - <i>Trend Home World Premiere Showing</i>               | 2003 - <i>The Ultimate Project, Ganttthead.mag</i>                            |
| 1961 - <i>Project Americana - Feedback</i>                    | 2003 - <i>Building a Better World, Industrial Engineer</i>                    |
| 1971 - <i>Redesigning a Culture - Science News</i>            | 2003 - <i>Proceso Mexico</i>  |
| 1990 - <i>Gulfshore Life</i>                                  | 2004 - <i>Redesigning the World - Irish Entrepreneur</i>                      |
| 1993 - <i>Lee Living</i>                                      | 2005 - <i>The Futurist</i>  |
| 1994 - <i>Predictions</i>                                     | 2006 - <i>Russian Mag</i>   |
| 1994 - <i>The Futurist- May</i>                               | 2006 - <i>The City of the Future - International Magazine of Space Design</i> |
| 1995 - <i>The Futurist</i>                                    | 2006 - <i>The Future By Design Review - Library Journal</i>                   |
| 1995 - <i>The Venus Project - Media Wave</i>                  | 2006 - <i>USA Documentary Features - Oz</i>                                   |
| 1996 - <i>Epoca Spain</i>                                     | 2007 - <i>Gallery Russia</i>  |
| 1996 - <i>Weekly Reader.Jan12</i>                             | 2007 - <i>Photoshop Turkey</i>  |
| 1996 - <i>Journal of the Synergetic Society</i>               | 2008 - <i>FHM Spain</i>   |
| 1997 - <i>Detour.New York</i>                                 | 2008 - <i>Amusement</i>   |
| 1997 - <i>Gallery Russia</i>                                  | 2008 - <i>Diyalog.Turkey</i>  |
| 1998 - <i>Shift.Canada</i>                                    | 2008 - <i>GO Arc and Design Issue</i>   |
| 1998 - <i>Weekly Reader.Jan 23</i>                            | 2008 - <i>IN Center Life Turkey</i>   |
| 1998 - <i>Welcome To The Future - Video Librarian</i>         | 2008 - <i>VS.Gelectekten.Haber.Var</i>  |
| 2000 - <i>FX.UK</i>   | 2009 - <i>Chic</i>  |
| 2000 - <i>The Venus Project - Sun.2-19</i>                    | 2009 - <i>Geo</i>   |
| 2000 - <i>The Compass.ExxonMobil</i>                          | 2009 - <i>Zeitgeist - Pajavasara</i>  |
| 2001 - <i>GQ.Italy</i>  | 2009 - <i>Greek, Focus</i>  |
| 2001 - <i>Jonas.France</i>                                    | 2010 - <i>Agora</i>   |
| 2001 - <i>Locun Destination Review</i>                        | 2010 - <i>Resource Based Economy - Natural Communities</i>                    |
| 2001 - <i>Venus Sur Mer - Jonas France.</i>                   | 2010 - <i>The Future By Design - Positive Life</i>                            |
| 2002 - <i>Mare.Germany</i>                                    | 2010 - <i>The World According to Fresco - Future Orientation</i>              |
| 2002 - <i>Engineering A New Future of Tomorrow - Futurist</i> | 2010 - <i>Vsi Lahko Zivimo V Blaginji - Viv</i>                               |
| 2002 - <i>Sea Cities - Futurist</i>                           | 2011 - <i>Re-engineering The World With   Crazyengineers.com</i>              |

## Gazeta

- |   |  |   |
|---|--|---|
| 1947-1961 - <i>Trend Home Articles</i>    | 1986 - <i>The News-Sun</i>                     | 2000 - <i>National Hotel Executive</i>  |
| 1947 - <i>L.A. Evening Herald Express</i> | 1986 - <i>The Sebring News</i>                 | 2000 - <i>Sun.2-19</i>                  |
| 1950 - <i>Newspaper</i>                   | 1988 - <i>The Sebring News</i>                 | 2002 - <i>Houston Chronicle</i>         |
| 1956 - <i>Miami Herald</i>                | 1988 - <i>Lake Placid Journal</i>              | 2002 - <i>TheHerald.7-11</i>            |
| 1961 - <i>Miami News</i>                  | 1993 - <i>21st Century News</i>                | 2002 - <i>Weekend Reader</i>            |
| 1973 - <i>Miami Herald</i>                | 1996 - <i>Sunday News Press</i>                | 2004 - <i>Nova</i>                      |
| 1976 - <i>Miami Herald</i>                | 1996 - <i>The Daytona Beach Sunday Journal</i> | 2008 - <i>Germany.Villiam @ ofir.dk</i> |
| 1979 - <i>Hollywood Sun- Tattler</i>      | 1996 - <i>The News- Sun</i>                    | 2008 - <i>Pazartsi.Turkey</i>           |
| 1981 - <i>Lake Placid Journal</i>         | 1997 - <i>The News- Journal.5-19</i>           | 2008 - <i>The Free Press</i>            |





# Potentials of Technology

**H**undreds of books and articles address technological change and make predictions. What is usually missing is an explanation of the constraints placed on technological development by the social system in which it occurs.

Today, financial barriers place enormous limitations on the innovation, individual creativity, and incentives, which have the potential to liberate humanity from its most pressing problems. Our existing economic and political structures are no longer able to keep up with changes in technology. Profit, secrecy, and competition hinder its implementation.

We are at a time when the methods of science and technology can provide abundance for all if managed intelligently. It is no longer necessary to consciously withhold efficiency through planned obsolescence and artificial scarcity. Continuing our old monetary system promotes these practices. In our high-energy civilization, rationing resources though monetary manipulation is no longer relevant, but is counter-productive to our survival.

With computers processing trillions of bits of information per second existing technologies far exceed human capacity for making reasonable decisions about the development and distribution of resources. With this processing potential we can surpass the practice of decisions being made on the basis of power and advantage.

Soon most will realize that a cybernated society can benefit humanity more than any other development in history. Here we do not contemplate the use of technology to advance the interests of transnational corporations, but rather to organize a global economy based on human rights and basic needs.

All people, regardless of race, color, or creed, need clean air and water, food, shelter, medical care, and education. Supplying these needs is a technical problem, not a political one.


The Venus Project's solution, a resource-based economy, uses the methods of science to arrive at a sustainable future. All resources are available to everyone without money, barter, credit, debt, or servitude of any kind. Within a resource-based economy,

all resources are the common heritage of all people.

This can be achieved with technology and cybernetics if they're used with human and environmental concern to secure, protect, and develop a more humane world for everyone.

To achieve this we must first survey and inventory what we have to work with, namely the resources, technical personnel, manufacturing plants, and the needs of people. Our plans must be doable within the carrying capacity of Earth's resources.

While many urban centers grapple with retrofitting new and more efficient tech-



Designed by Jacque Fresco ([www.thevenusproject.com](http://www.thevenusproject.com))


nologies into existing infrastructures, these efforts fall short of the potentials of technology. We must rebuild our physical infrastructures using total city system designs. Industrial plants, waterways, power systems, production and distribution processes, and transportation systems must be reconstructed from the ground up with a total global-systems approach. Only then can technology overcome resource deficiencies and provide universal abundance.

Automated control could happen using sensors to monitor the earth's resources from every conceivable location. These could be linked together using a worldwide network of computers. Instead of policing human behavior, these monitors would help us arrive at the most appropriate decisions for humans and the environment. Monitoring personal behavior will be neither necessary nor desirable within a global resource-based economy since everyone will have access to the necessities of life.

If technology were managed intelligently with human and environmental concern, it could overcome scarcity and liberate millions of humans from poverty, hunger, crime, and war. There would then be no limit to human potential.

One purpose of this technology is to free people from dangerous, repetitive, and boring jobs, and allow them to experience the fullness of human relationships, denied to so many for so long. This calls for a basic adjustment in how we think about what it means to be civilized.

Do we have the capacity, the will, and the intelligence to clearly think through and implement changes for our overall benefit, or must we wait for some catastrophic event to direct our future? **[1]**



**Jacque Fresco**  
Director and Founder  
of The Venus Project

Mr. Fresco's background includes industrial design and social engineering, as well as being a forerunner in the field of Human Factors. Mr. Fresco has worked as both designer and inventor in a wide range of fields spanning from biomedical innovations to totally integrated social systems.

He has authored books such as *Introduction to Sociocyberneering*, *The Venus Project: The Redesign of a Culture*, *Designing the Future*. He has also produced and filmed *The Venus Project*, *Cities in the Sea*, *Designing the Future*.



# Tema Diskutimi

- *Projekti Venus një model për ndryshim pozitiv. Nuk është e mjaftueshme të ankoresh për pabarazitë pa propozuar një alternativë.*
- *Si arriti Jacque Fresco në këtë drejtim.*
- *Ekonomia e Bazuar në Burime, ku çdo gjë është e disponueshme "pa një etiketë çmimi".*
- *Aspektet dhe përfitimet të qyteteve të para planifikuara "Qëndrueshëm Jeshil" ose "Sisteme të Përgjithshme*
- *Aplikimi i Metodës Shkencore në sistemin social.*
- *Si ndikon mjedisi në sjelljen dhe në vlerat tona.*
- *Duke ndryshuar vlerat njerëzore.*
- *Proçesi i nevojshëm për të menaxhuar krijimtarinë dhe individualitetin.*
- *Njerëzit janë të detyruar t'u shërbejnë interesave të kulturës së themeluar.*
- *Ndryshimet e kërkuara që na nevojiten për mundësimin e arritjes së qëndrueshmërisë.*
- *Duhet të jetojmë në përputhje me kapacitetin mbajtës të burimeve të Tokës.*
- *Proçesi për të arritur nga sistemi aktual në Ekonominë e Bazuar në Burime.*
- *Si ndryshon ky sistem nga Komunizmi ose Socializmi.*
- *Qendra Kërkimore në Venus të Florida-s.*

## Contact

Jacque Fresco & Roxanne Meadows  
The Venus Project

21 Valley Lane  
Venus, Florida  
33960  
USA

Office: +1 863 465 0321  
Email: [tvp@thevenusproject.com](mailto:tvp@thevenusproject.com)

[www.thevenusproject.com](http://www.thevenusproject.com)